


Informacion mbi takimin e organizuar nga EUROSAT IT Working Group (ITWG)

Në datë 11 dhjetor u zhvillua online takimi i radhës “virtual coffee break with a colleague” mbajtur nga EUROSAT IT Working Group, me pjesëmarrjen nga anëtarë të SAI-ve të ndryshëm, i cili u ndoq dhe nga dy auditues të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Takimi u hap me një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve “virtual coffee break with a colleague” të zhvilluara më parë, i cili është i aksesueshëm vetëm për anëtarët e Grupit të Punës për IT të EUROSAT-t.

Tema e zhvilluar në këtë takim ishte “*Kontrolli i sistemit të informacionit që mbështet përgatitjen e Llogarisë Shtetërore*” nga Gjykata e Auditorëve Portugezë.



Gjatë prezantimit të temës u trajtuan informacione të ndryshme si: auditimi mbi efektivitetin operacional të kontroleve të brendshme, auditimi mbi përputhshmërinë me kërkesat e informacionit të konsolidimit dhe rregullat e vlefshmërisë, si dhe u prezantuan disa nga gjetjet kryesore.

Takimi u zhvillua në formë bashkëbisedimi ku çdo anëtar drejtoi pyetje nëpërmjet platformës ZOOM. Në përfundim, u diskutua mbi takimin e radhës, i cili është planifikuar të zhvillohet në muajin janar nga Sekretariati i ITWG.